



*Ta njohim trashëgiminë kulturore
dhe natyrore të Komunës së
Zaçanikut*



Të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut

Në këtë katalog do të kení mundësinë të njoftohení me vendet që paraqesin lashtësinë e qytetit tonë. Secíli objekt í paraqitur në këtë katalog tregon më së miri lashtësinë e popullit shqiptar, adetet e zakonet që mbijetun ndër shumë vite.

Ky katalog është pjesë e projektit “ Ta njohim Trashëgiminë Kulturore” që është përkrahur nga fondacioni suedez “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” zyra në Kosovë, ndërsa është një nga prioritetet e Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore të Kaçanikut të hartuar nga CHwB dhe Komuna e Kaçanikut.

Komuna e Kaçanikut posedon një trashëgimi shumë të pasur kulturore e natyrore, e cila daton që nga kohërat e lashta. Identifikimi dhe njohja më për se afërmí me këto resurse do t'i shërbente zhvillimit ekonomik dhe social të Komunës sonë.

Duke e konsideruar si mjaft të nevojshme iniciativën për ruajtjen e vlerave të ndryshme kulturore e natyrore, kemi përpiluar një katalog í cíli është udhërrëfyes dhe një përmbledhje e traditës dhe kulturës mbi respektin, mikpritjen dhe pasurinë që ne kemi trashëguar nga brezat e mëparshëm dhe ne të njëjtat vlera , të njëjtën traditë po e bartim te qytetarët tanë e me një potencë të veçantë tek brezat më të rinjë.

Investimi në trashëgimin kulturore është investim në ngritjen e identitetit shtetëror, është respektimi í shoqërisë sonë dhe respekt í pasurisë së kësaj shoqërie.

*Emri: Kalaja e Kaçanikut
Koha e ndërtimit: Antikë, Antikë e Vonë, Mesjetë.
Vendi: Rruga Agim Bajrami- Kaçanik*



Kjo kala ka pasur gjithsej 55 shtëpiza. Është ndërtuar nga Koxha Sinan Pasha dhe konsiderohet si njëri ndër objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Komunës së Kaçanikut.





*Emri: Xhamia e Sinan Pashës
Koha e ndërtimit: Viti 1594/95
Vendi: Rruga Qamil Ilazi-
Kaçanik*



Kjo xhami vlerësohet për shkak të lashtësisë që ka dhe është ndërtuar nga Koxha Sinan Pasha. Në vitin 2013 është bërë restaurimi i xhamisë nga qyteti Bursa në Turqi.





*Emri: Gryka e Kaçanikut
Vendi: Magjistralja Kaçanik- Hani i Elezit*

Në mes të këtij guri është ndërtuar magjistralja Prishtinë - Shkup dhe krijon një pamje piktoreske për të gjithë kalimtarët.






*Emri: Kalaja Antike e
Kaçanikut
Koha e ndërtimit: Shekulli III
Vendi: Rruga Tefik Raka,
mbi Gurin e Shpum*




*Është kala e vjetër e
ndërtuar nga Koxha
Sinan Pasha dhe është
përdorur si vend
strategjik për vendosjen e
topave, prej nga e ka
marrë edhe emrin Kalaja
e Tophanes.*



*Emri: Maja e Lubotenit
Vendi: Rruga Guri i Zifshati Shtrazë*



Maja e Lubotenit është majë e maleve të Sharrit dhe ndodhet në pjesën perëndimore të Kaçanikut që është 2,498 metra e lartë. Konsiderohet si maja më e bukur e maleve të Sharrit.





*Emri: Oda e Familjes Luzha
Koha e ndërtimit: Viti 1840
Vendi: Fshati Bëgracë-
Kaçanik*




*Oda e Familjes Luzha
është e lashtë mbi 100
vjet dhe në vitin 2013
është intervenuar në
kuadër të masave
emergjente nga CHwB-
ja, Komuna e Kaçanikut
dhe MKRS. Ky
monument gjendet në
listën e mbrojtjes së
monumenteve të
trashëgimisë kulturore
nga MKRS.*



*Emri: Bukuritë Natyrore
të Malit Sharr
Vendi: Fshati Shtrazë-
Kaçanik*



*Fshati Shtrazë shquhet
për bukuritë natyrore.
Gjatë stinës së verës
frekuentohet nga shumë
qytetarë si nje vend
turistik me shumë
hapësira të gjelbëruara.*





*Emri: Shtëpia e Ismajl Rakës
Koha e ndërtimit: Viti 1986
Vendi: Rruga Tefik Raka (Guri i Shpum)*

Shtëpia e Ismajl Rakës ka një rëndësi të veçantë për historinë më të re. Në këtë shtëpi ka jetuar dëshmori i UÇK Ismajl Raka. Opinioni publik është duke kërkuar që kjo shtëpi të shpallet muze.



*Emri: Sofra e Çobanëve
Vendi: Lagjja Rakoc- Kaçanik
Koha e ndërtimit: Nuk ka të dhëna*

Është një gur natyror, tek i cili që nga kohërat e lashta çobanët (barinjtë) hanin bukë në të. Mbahet mend nga shumë e shumë gjenerata.





*Emri: Kulla Shaip Hysaj
Koha e ndërtimit: Nuk
ka të dhëna
Vendi: Fshati Stagovë-
Kaçanik*

*Në Kullën e Shaip Hysajt
është intervenuar në kuadër
të masave emergjente në
vitin 2013 nga CHWB-ja,
Komuna e Kaçanikut dhe
MKRS. Kjo kullë gjendet në
listën e mbrojtjes së
monumenteve të
trashëgimisë kulturore e
MKRS.*





*Emri: Kulla e Rufki Brahës
Koha e ndërtimit: Shekulli
XIX
Vendi: Fshati Stagovë-
Kaçanik*

Kulla e Rufki Brahës është një kullë shumëvjeçare dhe për shkak të vlerave të saj është intervenuar në kuadër të masave emergjente në vitin 2013 nga CHwB-ja, Komuna e Kaçanikut dhe MKRS. Kjo kullë gjendet në listën e mbrojtjes së monumenteve të trashëgimisë kulturore e MKRS.





*Emri: Kulla e Halit Selmanit
Koha e ndërtimit: Shekulli
XIX
Vendi: Fshati Stagovë-
Kaçanik*



Kjo kullë është mbi 100 vjeçare e lashtë dhe ende i ka rezistuar kohës. Kulla e Halit Selmanit gjendet në listën e mbrojtjes së monumenteve të trashëgimisë kulturore nga Ministria e Kulturës (MKRS).



*Emri: Salla e shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut
Vendi: Shtëpia e Kulturës- Kaçanik*

Në këtë sallë u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës më 7 Shtator 1990, ndërsa që nga ajo kohë kjo hapësirë mbetet origjinale pa asnjë ndryshim.





Teksti: Fatlume Guri - koordinatorë e projektit

Fotografitë: Arif Mulaku - profesor i artit

*Financues: Trashëgimia kulturore pa kufij (CHWB)
zyra në Kosovë*

*Implementues: Këshilli i Veprimt Rinor Lokal në
Kaçanik KVRL në bashkëpunim me Komunën e
Kaçanikut*

